



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**  
**DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2019

**DEKLARATË**

**PËR CILËSINË E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË MINISTRISË SË  
ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË PËR VITIN 2018**

Unë i nënshkruari Oltjon Muzaka, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo-financiare të njësisë si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i Njësisë, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë, në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas nenit 9 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010. “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë gjatë vitit raportues 2018, nëpërmjet:

- Koordinimit të takimeve me drejtorët e drejtorive në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut.
- Këshillimit dhe dhënies së instruksioneve menaxherëve të tjerë të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe tek Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Ministrisë.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklarate, pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Oltjon MUZAKA**

**NËPUNËS AUTORIZUES**

**Shënim; Z. Oltjon Muzaka** është emëruar në pozicionin e Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me shkresën nr. 206/1 prot., datë 10.01.2019 të Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 571/1, datë 21.1.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë caktohet nëpunës Autorizues për MASR, si dhe shkresën nr. 631/1, datë 08.02.2019 **Z. Oltjon Muzaka**, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë është konfirmuar, Nëpunës Autorizues Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ.

Z. O. Muzaka me Udhërin nr. 43, datë 24.1.2019 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, i janë deleguar të kompetencat e përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

## RAPORT

### “PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË MINISTRISË SË ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË PËR VITIN 2018”

#### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2018, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, në përmbushje të misionit dhe funksionimit të strukturave në varesi të saj, ka vazhduar të rrisë performancën e punës së saj, me qëllimin realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013–2020, detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE, si dhe detyrime të tjera sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë janë krijuar tashmë sistemet e kontrollit të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim duke synuar drejt përmbushjes optimale të objektivave.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore.

Në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe të Vendimin nr.128, datë 07.3.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, Udhëzimin nr.7/1 datë 28.2.2018 i Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021.”

Përgatitja e kërkesave buxhetore afatmesme 2019 – 2021, është realizuar mbështetur në Vendimin nr.11 datë 11.01.2016 të KM "Për miratimin e strategjisë së arsimit parauniversitar", strategjinë për kërkimin shkencor miratuar me Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022", si dhe strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2013-2020, si dhe në tavanet përgatitore të miratuara me Vendimin nr.128, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021” dhe Vendimin nr.476/2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”,.

**Me Urdhrin nr. 153, datë 03.04.2018** të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore si ASCAL, AKKSHI, IZHA, ISHA, Agjencia për Rininë, etj.

**Me Urdhrin nr. 154, datë 03.04.2018** të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2019-2021", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore ASCAL, AKKSHI, IZHA, ISHA, Agjencia për Rininë, etj.

Të gjithë drejtuesit titullarët, drejtues të nivelit të mesëm apo të ulët në njësi, kanë përfituar trajnime afatshkurtra më qëllim që të janë të vetëdijshëm në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar edhe kontrollit të brendshëm MFK-së, jo vetëm specialistët me qëllimi që të sigurojë:

- a) drejtimin e operacioneve në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efikase dhe efektive;
- b) përfaqshjen e operacioneve me ligjet, rregulloret, politikatat, planet dhe procedurat;
- c) ruajtjen e aktiveve dhe burimeve të tjera kundrejt humbjeve të shkaktuara nga keqadministrimi, shpenzime dhe përdorime të panevojshme, si dhe kundrejt parregullsive dhe mashtrimit;
- d) forcimin e përgjegjësisë menaxheriale për një arritje të suksesshme të objektivave të vendosura;
- e) raportimin financiar në kohë dhe monitorimin e rezultateve të performancës.

Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i sistemeve efikase të MFK-së do të ndihmojë në përshtatjen më të lehtë të njësisë ndaj ndryshimeve me të cilat ajo do të përballet në mjedisin e jashtëm apo të brendshëm.

Ministria e Arsimit Sporti dhe Rinisë për vitin 2018 ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Lartë”
5. Programi “Kërkimi shkencor”.
6. Programi “Për sportin dhe Rininë”.

Për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë në gjashtë programet buxhetore të janë hartuar deklaratat e misionit si dhe objektivat themelore për sigurimin e një menaxhimi eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare.

Gjatë vitit 2018 një nga problemet kryesore në kuadër të konsolidimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm ka qenë konsolidimi i strukturave, në mënyrë që ato të sigurojnë se detyrat, hierarkia, linjat e raportimit dhe përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit janë ndarë siç duhet në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë.

Janë rishikuar strukturat sipas Vendimit nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë”, si dhe të Urdhrit të **Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017** të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë", strukturë e cila është implementuar brenda 2017.

MASR me shkresën nr. 8018/1 si dhe shkresën nr. 8018/2, datë 29.08.2018, si dhe me shkresën nr. 7048/1, datë 25.10.2018 dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë "Mbi ristrukturimin e Ministrisë së Arsimit Sporti dhe Rinisë", ka kërkuar ristrukturimin për aparati të MASR i miratuar më Urdhrit e kryeministrit nr. 163, datë 07.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MASR";

**Gjatë kësaj vitit 2018 në MASR**, është punuar me përkushtim për zhvillimin dhe implementimin e reformës në arsim dhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara në planin e punës për “Marticën e akteve ligjore dhe nënligjore për vitin 2018”;

1. Janë propozuar për miratim në KM, për ndryshime në 2 akte ligjore dhe janë miratuar proceduar për miratim në KM projekt-ligji për sportin i miratuar në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe projekt-ligji për disa ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në RSH”.
2. Janë hartuar dhe propozuar për miratim në KM, rreth 24 projektvendime, për ndryshime në akte nënligjore dhe janë miratuar në KM 21 (njëzetë e një) vendime.
3. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR, 33 udhëzime të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë.
4. Janë hartuar dhe propozuar për miratim në titullarët e MASR, 679 urdhra të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë.
5. Gjatë vitit 2018, janë realizuar 38 raporte monitorimi për institucionet publike dhe private të arsimit të lartë “Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion”.

6. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), së bashku me një agjenci britanike anëtare e ENQAS gjatë vitit 2017-2018 ka realizuar vlerësimin institucional në 37 IAL-ve dhe së bashku me vlerësimin e realizuar në vitin 2018 janë realizuar 35 vlerësime institucionale.
7. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), gjatë vitit 2018 ka realizuar akreditim të 67 programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë.
8. Në bashkëpunim me DAP janë realizuar procedurat për shpalljen e publikimeve për plotësimin e nevojave për **20 vendeve vakante për 2018, për nëpunësit civilë të MASR, dhe 7 vendeve vakante të AKKSHI**, ndërsa për institucionet e varësisë qendrore dhe rajonale/vendore (ISHA/IZHA/DAR-ZA) nuk është bërë planifikimi pasi kanë qenë në proces ristrukturimi; ndjekja e të gjithë procesit të shpalljes së vendeve vakante, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe institucionet qendrore dhe rajonale vendore të varësisë; caktimi i punonjësve të MASR në Komisionet e përzgjedhjes së kandidatëve, etj.
9. Ndjekja e procesit të konfirmimit të **20 punonjësve të MASR**, dhe të institucioneve të varësisë pjesë të shërbimit civil, si nëpunës civilë, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të provës në shërbimin civil.
10. Ndjekja e grafikut të trajnimeve pranë ASPA-s, për **10 punonjësit e MASR, si dhe 21 punonjës NC dhe NZ** të varësisë të cilët janë rekrutuar gjatë 2017 si dhe trajnimet e tjera jashtë vendit kryesisht të ofruara nga ReSPA.
11. Raste të shkeljes e rregulloreve, kodit të etikës, rregullave të procedurave trajtohet në mënyrën e duhur.
12. Ndjekja e grafikut të trajnimeve pranë ASPA-s, për **34 punonjësit e MASR, si dhe 94 punonjës NC dhe NZ** të varësisë si dhe trajnimet e tjera jashtë vendit kryesisht të ofruara nga ReSPA.
13. Raste të shkeljes e rregulloreve, kodit të etikës, rregullave të procedurave trajtohet në mënyrën e duhur.
14. Hartimi i projekt-strukturave të MASR për **tre** institucioneve të varësisë. Përgatitja e Relacionit dhe Urdhrave përkatës për ndryshimin e strukturave të MASR si dhe ndjekja e korrespondencës me Ministrinë e Financës dhe Departamentin e Administratës Publike;
15. Mbledhja e të dhënave të dërguara nga DAR/ZA-të për planifikimin e numrit të punonjësve për vitin e ri shkollor 2017-2018, dhe kontrolli i korrektesisë së informacionit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi për numrin e mësuesve/ nxënësve për klasë, pas monitorimit të realizuar në muajin shtator në 38 DAR/ZA, për normat dhe ngarkesën mësimore në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

## II. VLERËSIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, kontrolli i brendshëm është një ndër preokupimet kryesore të menaxhimit të lartë që trajtohen me prioritet nga Titullari i Ministrisë, drejtuesit e programeve buxhetore, nëpunësit autorizues të nivelit të dytë dhe nëpunësit zbatueses duke synuar një mbështetje të gjerë të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mbështetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si edhe udhëzimet e dhëna nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave, titullarët e të gjitha njësive janë përgjegjës, për krijimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm brenda strukturës që drejtojnë.

Gjatë vitit 2017-2018 nga Ministria e Financave, nisur nga performanca pozitive jemi autorizuar me të drejtat për të punuar drejtpërdrejt në modulën e Buxhetit në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), si Institucione Buxhetore të Nivelit të Parë sipas hierarkisë me të drejtën e autoritetit për regjistrimin dhe aprovimin e transaksioneve lidhur me buxhetin, kontratatave, pagesave, rishpërndarjeve të buxhetit, si dhe hedhjes në sistem SIFQ të fondeve të miratuara për dy vitet pasardhës.

### Mjedisi i kontrollit

Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të

çdo njësie, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm), në çdo njësi të qeverisjes qendrore, si dhe me drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

Në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Udhëzimin nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Udhëzimin nr.7/1 datë 28.2.2018 i Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021.”, ky proces është drejtuar dhe organizuar edhe në institucionet e tjera të sistemit arsimor.

Procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore afatmesme 2019 – 2021, jemi mbështetur të Vendimin nr.128, datë 07.3.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, si dhe Vendimin nr.476/2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”.

**Me Urdhrin nr. 153, datë 03.04.2018** të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore si ASCAL, AKKSHI, IZHA, ISHA, Agjencia për Rininë, etj.

**Me Urdhrin nr. 154, datë 03.04.2018** të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2019-2021", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore ASCAL, AKKSHI, IZHA, ISHA, Agjencia për Rininë, etj.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr. 183, datë 23.6.2014 “Për përgatitjen dhe hartimin e kombëtare për zhvillimi dhe integrim, 2014-2020”, janë hartuar dhe miratuar strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, përkatësisht: Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2014-2020) e cila përfshin strategjitë ndërsektoriale të arsimit parauniversitar. Me Vendimin nr.11, datë 11.01.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar, për periudhën 2014-2020”, si dhe Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”.

Në përputhje me metodologjinë e hartimit dhe finalizimit të këtyre dokumentave strategjikë, MASR ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit sipas kalendarit të aktiviteteve të parashikuara për secilën strategji, dhe është në procesin final të miratimit të strategjive.

Në zbatim të Vendimit nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë”; është hartuar struktura e organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe miratuar me **Urdhrin e Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017** të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë", strukturë e cila është implementuar brenda 2017.

**Në vitin 2017, me Urdhrin e Ministrit nr. 2457, datë 9.3.2017**, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore ekzistues mbi etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet ndërmjet drejtuesve dhe të tretëve. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe marrëdhëniet

ndërmjet niveleve të ndryshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi koordinimin e funksioneve, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullat e etikës dhe procedura të tjera të menaxhimit.

Në rregullore ekzistojnë gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie e sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit. Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës, të cilat si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore dhe angazhimeve të reja ligjore që drejtoritë duhet të përmbushin në kuadër të funksionimit të tyre, kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm.

Kryesisht mjedisi i kontrollit ndikohet nga struktura organizative e cila është rishikuar vetëm për aparatin e Ministrinë së Arsimit dhe Sportit dhe për një pjesë tjetër ka nevojë për rishikim në mënyrë që nivelet hierarkike dhe ato të raportimit të jenë të qarta, si edhe çdo objektivi dhe detyrë të jetë e mbuluar plotësisht dhe pa dublime.

Në të gjitha njësitë e varësisë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, janë përcaktuar Nëpunësit Autorizues si dhe Nëpunësit Zbatues **si dhe është njoftuar Njësia Qëndrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës.**

Në ushtrimin e përgjegjësiave nga titullarët ka procedura për delegimin e kompetencave bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe rregulloret e brendshme. Gjithashtu janë të miratuara përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe kryhen vlerësimet vjetore të punës mbi arritjet individuale në punë. Për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve realizohen trajnime të vazhdueshme nga MAS si dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike si edhe trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit.

### **Menaxhimi i Riskut**

Për vitin 2017, hartimi i Regjistrit të riskut dhe i strategjisë së minimizimit të tij është një proces me të cilin jemi informuar dhe marrë udhëzimet e nevojshme realizimin e detyrimeve sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, **kurse për vitin 2018**, regjistri është hartuar nga të gjitha programet buxhetore dhe aktualisht jemi në fazën e rishikimi të një regjistri përmbledhës dhe strategjisë së minimizimit riskut sipas strukturës së rishikuar, sipas fondeve buxhetore të miratuara m ligjin vjetor të buxhetit .

Mbështetur në objektivat dhe synimet strategjike për periudhën 2017-2020 objektivat e identifikuar në PBA 2019-2021, është hartuar Regjistri i Riskut, për çdo drejtori, si dhe shkalla e vetëvlerësimit të riskut sipas formularëve standard, duke marrë për referencë, të realizuara në manualin për menaxhimin financiar, shëmbullin e regjistrit të riskut të përgatitur nga Ministria e Financave, si dhe në strategjinë e Arsimit parauniversitar.

Për vitin 2018, në kuadër të implementimit të projektit “Implementimi i një Sistemi Modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Inspektimi Financiar Publik në Shqipëri”, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2018 është zhvilluar me tej produkti për përshkrimin e punës sipas drejtorive, plani i punës sipas drejtorive, harta e proceseve të punës, regjistri i riskut, shkalla e vetëvlerësimit të riskut sipas formularëve standard, gjurma e auditimi në procesin e hartimit të buxhetit afatmesëm, gjurma e auditimit të prokurimeve publike, gjurma e auditimit në menaxhimin e aktiveve, gjurma e auditimit në procesin e prokurimeve publike, planet e kontrollit të brendshëm, si dhe gjurma e proceseve të punës brenda drejtorive, sektorëve deri tek punonjësit për operacione të veçanta.

### **Veprimtaritë e Kontrollit**

Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Sporti, ushtrohen një sërë rregullash dhe procedura veprimi që synojnë reduktimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave, të cilat kanë natyrë kontrolluese, parandaluese apo

zbuluese. Gjatë aktiviteteve të ndryshme të punës kryhen kontrole të caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave.

Për saktësimin e të dhënave të përfshira në një dokument, ushtrohet sistemi me të paktën dy nivele kontrolli për punonjës/firma të autorizuar. Urdhër shpenzimet për kryerjen e pagesave autorizohet/ realizohen gjithmonë pas firmës së nëpunësit zbatues dhe nëpunësi autorizues.

Drejtimesit e Programeve "Planifikim Menaxhimi", "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm", "Arsimi i Lartë", dhe "Fonde për Kërkim Fundamental dhe Ekselencë", "Fonde për Sportin dhe Rinisë", janë iniciues të hartimit të PBA-se faza e parë dhe e dytë për periudhën 2019-2021.

Ndërsa për autorizimi i shpenzimeve të programeve respektive kryhet nga drejtorja përkatëse dhe personat e autorizuar/nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues. Gjithashtu kryhen edhe aktivitete të kontrollit të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

Reforma e Arsimit të Lartë një risi në politikë bërje përmes një procesi të veçantë që u ndoq për Reformën e Arsimit të Lartë. Kemi tashmë gati një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, e cila synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t'u arsimuar. Gjatë vitit 2018 është punuar për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për implementimin me sukses të reformës në arsimin e lartë.

Gjatë kësaj vitit 2018 në MAS është punuar me përkushtim për zhvillimin dhe imlementimin e reformës në arsim dhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara në planin e punës për "Marticën e akteve ligjore dhe nënligjore për vitin 2017";

1. Janë propozuar për miratim në KM, për ndryshime në **2 akte ligjore dhe janë miratuar proceduar** për miratim në KM projekt-ligji për Rininë, si dhe projekt-ligji për disa ndryshime në ligjin nr.69/2012 "Për arsimin parauniversitar në RSH", i miratuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin **ligjin nr. 48/2018**"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar
2. Janë hartuar dhe propozuar për miratim në KM, rreth 58 projektvendime, për ndryshime në akte nënligjore dhe janë miratuar në KM **51 (njëzetë e një) vendime** të Këshillit të Ministrave.
3. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR, **40 udhëzime të Ministrit** të Arsimit Sportit dhe Rinisë, si dhe Udhëzime të Përbashkëta me Ministrinë të Linjës
4. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR, **823 urdhra të Ministrit** të Arsimit Sportit dhe Rinisë.
5. Gjatë vitit 2018, janë realizuar **38 raporte monitorimi për institucionet publike** dhe private të arsimit të lartë "Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion".
6. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), së bashku me një agjenci britanike anëtare e ENQAS gjatë vitit 2017-2018 **ka përfunduar akreditimin institucional në 37 IAL-ve** dhe së bashku me vlerësimin e realizuara në vitin 2018 janë realizuar 35 vlerësime institucionale.
7. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), gjatë vitit 2018 ka realizuar akreditim të 67 programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë.  
Këto vlerësime janë të botuara në faqen zyrtare të Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). <https://ëëë.asc.al/sq/informacione/raportet-e-akreditimit-qa>.

#### **Të tjera**

Për vitin 2018, **në zbatim të** ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, janë propozuar dhe miratuar nga VKM, sa më poshtë vijon:

1. VKM nr. 432, datë 11.7.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", të ndryshuar.

2. VKM nr. 89, datë 14.2.2018 "Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve".
3. Vendim nr. 776, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2018-2019".
4. VKM nr. 89, datë 14.2.2018 "Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve".
5. Vendim nr. 600, datë 9.10.2018 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë".
6. Vendim nr. 540, datë 19.9.2018 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e shkollës së drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre."
7. VKM nr. 699, datë 21.11.2018 "Për miratimin e projektit pilot "Për masat për nxitjen e të nxënësve, të vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri", Korçë, për vitin shkollor 2018-2019".
8. VKM nr. 687, datë 14.11.2018 "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë".
9. VKM nr. 561, datë 29.9.2018 "Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare".
10. VKM nr. 562, datë 29.9.2018 "Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë".

#### **Të tjera**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", gjatë vitit 2018 janë miratuar, vendimet sa vijon;

1. Vendimi nr. 75, datë 12.2.2018 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor".
2. VKM Nr. 216, datë 20.4.2018, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019"
3. Vendim nr. 288, datë 21.5.2018 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë".
4. Vendimi nr. 781, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë".
5. Vendimi nr. 778, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr.288, datë 21.5.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar;
6. Vendimi nr. 779, d
7. atë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit";
8. Vendimi nr. 780, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë";



9. Vendimi nr. 784, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar;
10. Vendimi nr. 560, datë 29.9.2018 i Këshillit të Ministrave “për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga qendra e shërbimeve arsimore”.
11. Vendim nr. 88, datë 14.2.2018 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar (RASH)”.

## **Informacioni dhe Komunikimi**

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së brendshme të Ministrisë duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike. Kujdes të vecantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe drejtuesve. Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë janë trajnuar për përdorim të sigurtë dhe të drejtë të komunikimeve elektronike zyrtare bazuar në rregulloret e hartuar nga AKSHI mbi përdorimin e postës elektronike në administratën publike dhe përdorimin e shërbimit të internetit në administratën publike. MASR ka zbatuar të gjitha standardet TIK të hartuara nga AKSHI në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit të MASR dhe për ndërtimin e dhomës së serverave në ambientet e MAS-it.

Në rastet e shkeljes së afateve të caktuara janë marrë edhe njoftime për tërheqje vëmendje apo masë disiplinore nga eprorët direkt. Informacioni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në MASR.

Në MASR në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Informacionit (AKSHI), janë duke u zhvilluar programe nga Drejtoria e Teknologjisë Informacionit dhe Komunikimit, skema për back-up e database-ve dhe aplikacioneve të zhvilluara për Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, QSHA (ish-AKP), IZHA ISHA edhe Qendra e Shërbimeve të Rrjetit Telematik. Skemat back-up janë të testuara dhe të stimuluar në rast se sistemi do të ketë një pikë dështimi.

Përfundimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit (EMIS) në arsimin parauniversitar dhe atë universitar ka mundësuar rritjen e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin akademik dhe financiar në gjithë sistemin, që nga niveli i shkollës deri tek ai qendror.

## **Monitorimi**

Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit sipas standardeve të përcaktuara në **Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016** të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, është hartuar dhe raportuar për vitin 2017, si dhe për çdo 4-mujor, dhe në progresiv 8- mujor, dhe vjetor nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve për çdo program, si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MASR për vitin 2018. Monitorime të vecanta realizohet sa herë të lind nevoja apo Titullari kërkon nga drejtuesit e drejtorive dhe njësitë e varësisë të MASR.

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimi”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, **janë realizuar analiza dhe dërguar raporte dhe informacione për Titullarët dhe në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për vitin 2017, për çdo 3-mujor për vitin 2018, s dhe detyrimet akumuluar deri më 31 Dhjetor 2018**, i detajuar me të dhëna lidhur me;

1. *Historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikat e situatës, shkaqet dhe arsyet e pamundësisë së deritanishme për të shlyer këto detyrime, masat konkrete të marra deri tani në këtë drejtim;*
2. *Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të akumuluar deri në 31 Dhjetor 2018;*
3. *Vlera e likuiduar e detyrimeve të prapambetura deri më 31 Dhjetor 2018;*
4. *Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2019, si edhe për një periudhë afat-mesme.*

Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve përdoren një sërë procedurash nga titullarët, nëpunësit Autorizues dhe zbatues si dhe drejtuesit e tjerë të lartë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm titullari i MASR dhe nëpunësi autorizues përdor edhe auditimin e brendshëm të njësisë. Në MASR, Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm raporton direkt tek titullari, për çdo rast të auditimit të kryer në njësitë shpenzuese. Auditimi i brendshëm përveç kontrollit, konsiston edhe në dhënien e këshillave apo rekomandime të cilat kanë për qëllim përmirësimin e punës së MAS drejt arritjes së objektivave.

### **III. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TE BRENDSHËM DHE TË JASHTËM DHE INSPEKTORIATIT SHITETËROR TË ARSIMIT.**

**Funksioni i Auditimit të Brendshëm**, si veprimtari e pavarur ndihmon menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke vlerësuar në thellësi sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim që të përcaktojë nëse ato funksionojnë në mënyrë eficiente për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

**Struktura dhe organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është** në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.186, datë 18.10.2013 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”

**Drejtoria e Auditimit të Brendshëm për vitin 2018**, sipas planin vjetor të miratuar nga Ministri me nr. me prot/ nr. 10340, datë 12.10.2017, ka përcaktuar objektivat me programe konkrete, për realizimin e misionit të auditimit si:

- dhënies përparësi për auditim, atyre fushave që janë vlerësuar me rrishtë të mesëm dhe të lartë,
- përmirësimin e kapaciteteve të auditit,
- përmirësimin e programeve dhe metodologjisë së auditimit,

Për periudhën raportuese, Njësia e Auditimit, ka audituar kryesisht institucionet e vlerësuara me fonde të mëdha dhe të vlerësuara me risk në lidhje me përdorimin e fondeve, si dhe sisteme të ndryshme me risk të mesëm dhe të lartë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në institucionet e audituara, ka kryer vlerësimin sistemit të kontrollit të brendshme dhe nga këto vlerësime vërehet se, ka raste që këto sisteme janë ngritur por janë vlerësuar me nivel të dobët ose nuk funksionojnë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore.

#### **▪ Analiza e programeve të AB, për periudhën raportuese:**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjatë vitit 2018, i ka realizuar objektivat e parashikuara në planin vjetor të miratuar nga Ministri me prot/ nr. 10340, datë 12.10.2017.

Hartimi i planit vjetor të punës së DAB për vitin 2018, është bazuar në kapacitetet e burimeve që ka kjo drejtoria, në vlerësimin e riskut duke i dhënë prioritet institucioneve të mëdha dhe me më shumë fonde.

Për vitin 2018, në mbështetje të planit vjetor, ishin planifikuar për të u realizuar 18 auditime të kombinuara në 18 institucione

Në fakt janë realizuar 17 auditime të kombinuara dhe dy auditime tematike, në 19 institucione.

Janë dhënë një numër rekomandimesh, theksojmë se këto rekomandime kanë nivel të lartë pranimit nga Njësite Publike të audituara, por niveli i zbatimit të tyre nuk mund të përcaktohet qartë deri në përfundimin e

afateve raportuese. Procesi i zbatimit të rekomandimeve është në ndjekje të vazhdueshme si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve siguron informacion jo vetëm për vlefshmërinë dhe dobishmërinë e auditimeve, por mundëson dhe vlerësimin e cilësisë të punës së audituesve.

**Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre: gjatë vitit 2018, rezultuan gjetjet sistemeve me risk të lartë dhe të mesëm janë klasifikuar;**

Më poshtë është paraqitur tabela e parashikimit të risqeve sipas sistemeve pasqyruar në planin e vitit 2018, mbi bazën e së cilës DAB, ka vlerësuar dhe ka paraqitur edhe nivelin e riskut për sistemin arsimorë.

Planifikimi i angazhimeve të auditimeve është bërë mbi bazën e vlerësimit të riskut si më poshtë:

Nr	IDENTIFIKIMI I RISQEVE	VLERËSIMI I RISKUT		
		Mundësia e ndodhjes e lartë e mesme e ulët	Impakti i lartë i mesëm i ulët	Risku total i lartë i mesëm i ulët
<b>1</b>	<b>Risqet për Sistemet e Proceseve Organizative</b>			
	<b>1.1 Risqet në Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore</b>			
	<i>Ndryshimi i stafëve drejtuese në institucionet e arsimit larte</i>	I lartë	I larte	I larte
	<i>Rekrutimi i punonjësve dhe niveli i kualifikimit</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<b>1.2 Risqet në Sistemin e programit dhe zbatimit të buxhetit</b>			
	<i>Struktura e programit buxhetor</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
<b>2</b>	<b>Risqet për Sistemet e Pagesave</b>			
	<i>Mos pasqyrimi në kohë dhe i sakte i ndryshimeve në sistemin e pagesave</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Menaxhimi i funksionimit të sistemit të pagesave</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
<b>3</b>	<b>Risqet për Sistemet e Prokurimeve</b>			
	<i>Përzgjedhja e ofertës me të mirë</i>	I larte	I larte	I larte
	<i>Anulimi i procedurave të prokurimit</i>	I larte	I larte	I larte
<b>4</b>	<b>Risqet për Sistemet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar</b>			
	<i>Saktësimet në regjistrat e llogarive</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Niveli i besueshmërisë në informacion</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
<b>5</b>	<b>Risqet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit</b>			
	<i>Profesionalizmi i stafit dhe niveli i kualifikimit</i>	I larte	I larte	I larte
	<i>Saktësia në përpunimin e informacionit</i>	I larte	I larte	I larte
<b>6</b>	<b>Risqe të tjera lidhur me sisteme specifike sipas misionit dhe qëllimit të institucionit, (investimet publike, të ardhurat, etj)</b>			
	<i>Evidentimi jo i sakte i numrit të studenteve në arsimin e larte</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Arkëtimi i tarifës së shkollimit</i>	I larte	I larte	I larte
	<i>Ndryshimi i akteve normative për mënyrën e financimit</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Menaxhimi në sistemin e bursave</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm

**DAB, ka dhënë rekomandime, për të gjithë sistemin e MASR, si më poshtë:**

Gjatë vitit 2018, janë dhënë 45 rekomandime:

- a. **Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, gjithsej 3;**
  - Sistemi i kontrollit të brendshëm për funksionimin e njësisve shpenzuese, për plotësimin e organikave.
  - **Rekomandime të karakterit organizativ**, gjithsej 33 ; Sistemin e numrit të nxënësve në klasa; Funksionimi i Bordeve të administrimit; Sistemi i raportimeve dhe mirëqeverisjes.
  - **Rekomandime për arkëtime**, gjithsej 8; Arkëtimi i tarifës së shkollimit për pagesa të ndryshme në kundërshtim me aktet ligjore si dhe arkëtime të tarifave të studimit.
  - **Rekomandimet**, në mënyrë analitike sipas Institucioneve,
- a. **Rekomandime për përmirësimin e sistemeve:**
  - Menjëherë të merren masat dhe të veprohet sipas procedurave ligjore për plotësimin e pozicioneve të strukturave organike të pa plotësuara, në këto institucione: Zyrën Arsimor Gramsh, Zyrën Arsimor Tepelene, Zyrën Arsimor Mallakastër, Zyrën Arsimor Mirdite, Zyrën Arsimor Përmet, Zyrën Arsimor Kamëz, Dar Fier, Dar Elbasan.
  - Menjëherë të fillojë studimi për përqendrimin e shkollave, me nxënësve të kufizuar në Zyrën Arsimor Gramsh.
  - Të rishikohet struktura e personelit akademik, ndihmës akademik, si dhe administrativ në përputhje me ligjin nr.80/2015 si dhe nga ana e drejtorisë ekonomike të propozohen ndryshime në VKM për përputhjen e kategorizimit të personelit akademik me ligjin nr. 80/2015, Universiteti i Sporteve, Universiteti i Vlorës
- b. **Rekomandime të karakterit organizativ:**

- Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, si përfitues i fondeve “grand/transfertë korrente e brendshme, të paraqes në MASR dokumentacionin e përcaktuar në pikën 6 të Udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014.
- Të raportohen në MASR të ardhurat e përfituara nga burime të tjera të ligjshme, në zbatim të pikës 12 të udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014. - Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar
- Të ngrihet një komision “At-hok” për asgjësimin e kontingjenteve të teksteve shkollore gjendje që janë jashtë katalogut, si rekomandim i pa realizuar lënë nga auditimi i mëparshëm.

c. **Rekomandime për arkëtime:**

Për Universitetin e Vlorës: Pesë anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm institucional në kuadër të akreditimit të arkëtojnë shumën 610.571 leke. Anëtarët e senatit akademik dhe Kryetari të arkëtojnë shumat respektive 30.000 dhe 35.000 lekë, pasi janë paguar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të arkëtohen pagesat e përfituara për orë jashtë orarit nga punonjësit sipas urdhër shpenzimit nr.333, datë 08.11.2017 në shumën 2.063.293 lekë dhe urdhër shpenzimit nr.265, datë 05.10.2017 në shumën 1.606.500 lekë. Të gjithë përgjegjësit e sektorëve në rektorat të arkëtojnë diferencën e pagës së përfituar me IIIb nga kategoria IV/a që i takon sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017, lidhja nr.7. Të arkëtohen pagesat e përfituara për orë jashtë orarit nga punonjësit sipas urdhër shpenzimit nr.333, datë 08.11.2017 në shumën 2.063.293 lekë dhe urdhër shpenzimit nr.265, datë 05.10.2017 në shumën 1.606.500 lekë.

**Universiteti i Sporteve**, të arkëtohet vlera totale prej 18.974.738 lekë, tarifë shkollimi e pa arkëtuar nga studentët.

**Federata Volejbollit**, llogaritja e vjetërsisë në punë, për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe pozicionin e specialistit të bëhet mbi vlerën e pagës së grupit dhe jo mbi vlerën e pozicionit.

**ZA Gramsh** menjëherë, të fillojë ndalesat për 2 persona në shumën 18200 leke,.

**ZA Mallakastër**, të bëhet ndalesa për 8 punonjës paguar padrejtësisht për lejen e zakonshme për vitin 2017, me vlerë 481 236 lekë.

**Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit:**

Raporti vlerëson se, subjektet e audituara i kanë pranuar të gjitha rekomandimet dhe kanë treguar gadishmëri dhe seriozitet në realizimin e tyre.

Drejtorja e Auditimit, e ka konsideruar një nga sfidat e saj ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre, si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara, që ato të shërbejnë për ndreqjen e parregullsive e gabimeve dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Auditimet për zbatimin e rekomandimeve kanë qenë fokusuar në:**

- Sigurimin që, sistemi i bashkëpunimit të ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të jetë i dokumentuar në mënyrën e duhur.
- Sigurimin që, është kthyer përgjigje në kohën e duhur, si dhe nëse janë ndërmarrë veprimet korrigjuese në zbatim të rekomandimeve.
- Zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lidhen me çështjet e auditimit.

Deri me 31 Dhjetor 2018, është raportuar nga subjektet e audituara se janë realizuar 36 rekomandimet që kanë qenë në proces nga viti 2017, si dhe janë realizuar 11 rekomandime të vitit 2018, mbeten në proces 33 rekomandime të vitit raportues.

**Drejtorja e Auditimit të Brendshëm ka dhënë rekomandime për:**

- Përmirësime të sistemeve të kontrollit të brendshëm në tërësi;
- arkëtime të shkaktuara nga parregullsitë e konstatuara;
- përmirësim të sistemeve me karakter organizativ.

**Inspektorati Shtetëror i Arsimit ;**

Përgjatë vitit 2018, ISHA ka zhvilluar veprimtarinë e tij duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MASR. **ISHA ka zhvilluar funksionet e saj me veprimtari, të tilla si:** vlerësimi i cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore; kontrolli i pajtueshmërisë të veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; këshillimi i drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore e të njësive arsimore vendore; monitorimi i teksteve

shkollore; monitorimi i zbatimit të Dispozitave Normative, i Kodit të Etikës së mësuesit, punës së bordit të shkollës dhe të organeve kolegjiale të saj; monitorimi, vlerësimi, nxjerrja e përfundimeve dhe këshillimi për zhvillimin e arsimit parauniversitar; informimi i Ministrit, njësiteve arsimore vendore dhe institucioneve për gjetjet e inspektimeve arsimore; si dhe publikimi i veprimtarive të inspektimeve dhe vendimeve të marra nëpërmjet faqes zyrtare [ëëë.isha.gov.al](http://www.isha.gov.al).

*Gjatë vitit 2018 ISHA ka realizuar, 128 inspektime të programuara, përkatësisht:*

**13 inspektime të plota:** në 4 kopshte, 4 shkolla të arsimit bazë dhe 5 gjimnaze, me qëllim vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucioni arsimor, mbështetur në fushat e udhëzuesve zyrtar “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës” dhe “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit”, të përditësuara me Dispozitat Normative 2013 dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore.

*115 inspektime tematike për:*

- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në planifikimin vjetor lëndor dhe vlerësimin bazuar në kurrikulën me kompetenca;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar për mësimdhënien në lëndën e edukimit fizik;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në procesin e hartimit dhe zbatimit të projekteve lëndore dhe ndër-lëndore;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në menaxhimin e shkollës dhe klimën, etikën dhe kujdesin ndaj nxënësit;
- verifikimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në realizimin e procesit të praktikave profesionale për mësuesit;
- verifikimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë lidhur me funksionimin e institucioneve arsimore private bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore;
- verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë inspektimeve të zhvilluara në institucione arsimore parauniversitare;
- verifikimin e zhvillimit të procesit për realizimin e Kartës së Performancës së Shkollës;
- riinspektimin e realizimit të rekomandimeve të lëna.

**44 inspektime të orientuara jashtë programit, ndër të cilat:**

- 5 për vlerësimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore private, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 39 për shqyrtimin e rasteve të ankimeve, përkatësisht 28 raste nëpërmjet komunikimit me DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore përkatëse dhe 11 nëpërmjet inspektimeve të drejtpërdrejta me autorizim/Urdhër MASR-i në terren.

**350 monitorime lidhur me:**

- Praktikat profesionale;
- Klasat kolektive;
- Portalin “Mësues për Shqipërinë”;
- Olimpiadat;
- Testimin e klasave V;
- Përgatitjen për zhvillimin e Maturës Shtetërore;
- Procesin e vlerësimit gjuhësor të teksteve shkollore;
- Maturën Shtetërore 2018;
- Provimet e Lirimit 2018;
- Përzgjedhjen dhe shitjen e teksteve shkollore;
- Mospërdorimin e celularit gjatë procesit mësimor;
- Cilësinë e ofruar nga agjencitë trajnuese në trajnimet e mësuesve.

**Strukturës Organizative dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore MASR si dhe DAR/ZA;**

- Struktura e DAR/ZA-ve është ndërtuar konform VKM-së Nr.199, datë 01.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, mbështetet në rregulloren e brendshme, të miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 6, datë 10.01.2011, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës".

- Strukturën e MAS të miratuar me Urdhrin **nr.92, datë 29.6.2015** të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 23, datë 10.02.2015 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, strukturë e cila është implementuar brenda 2015.
- **Urdhrin e Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017** të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë”, strukturë e cila është implementuar brenda 2017.
- Numri i punonjësve për çdo DAR/ZA është në përputhje me numrin e përcaktuar në strukturën e urdhrin të Kryeministrit, por jo të gjithë punonjësit në DAR plotësojnë kriteret e nëpunësit civil.
- Në disa institucione është konstatuar mungesë dokumentacioni në dosjet e personelit.
- Në disa raste vendimet/urdhrat e drejtorëve të DAR-ve për emërimet “komandime”, të punonjësve janë në kundërshtim me rregullore e miratuar dhe në shumicën e rasteve janë të paargumentuara.
- numër mësuesish pa arsimin përkatës, mësues që japin mësim jashtë profilit, numër punonjësish mësimor **më shumë në organikë**, duke mos zbatuar normat e ngarkesës të përcaktuara me aktet e nxjerra nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (në disa DAR/ZA).
- Në të gjitha DAR-et nuk ka raporte të plota monitorimi apo vlerësimi konform të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, relacione apo studime për zëvendësim e ndryshim të numrit të punonjësve në institucione të ndryshme arsimore.
- Në shumë raste numri i punonjësve në DAR/ZA-ve i miratuar sipas strukturës, është i paplotësuar dhe punonjësit aktualë e kanë të pamundur të plotësojnë punës e vendeve vakante.
- Specialistët në DAR/ZA, në disa raste, nuk kanë përshkrim të detajuar pune, ose nuk kanë të raportuar produkte të punës së tyre, në disa raste konstatohet se punojnë tërësisht jashtë funksioneve apo sektorit të tyre.

#### **Misioni dhe Qëllimit të Institucionit**

- Në disa institucione të varësisë është konstatuar se nuk është miratuar rregulloja e brendshme.

#### **Programin dhe Zbatimi të buxhetit**

- Në disa institucione është konstatuar se **nuk zbatohet planifikimi analitik** në buxhetin vjetor;
- Janë paguar më shumë punonjës të ndryshëm; si pagesa për trajnime, seminare, honorare dhe dieta në kundërshtim me aktet normative;
- *Pagesa për mësues pa mbështetur në akte ligjore.*
- Janë gjetur, pagesat apo akte rakordimi të pa firmosura nga përgjegjësi i burimeve njerëzore.

#### **Sistemin i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar**

- Në disa institucione është konstatuar se kontabiliteti nuk mbahet sipas parimit të të drejtave të konstatuara;
- Nuk mbahet praktika dokumentare për shpenzimin e karburantit, konform ligjit.
- Nuk ka një sistem të qartë të monitorimit, raportimit dhe **verifikimit të normës mësimore** për punonjësit mësimorë në Arsimin Parauniversitar.

#### **Arkëtimin i të ardhurave,**

- Për vitin 2017-2018 të ardhurat e realizuara nga institucionet e sistemit të arsimit janë arkëtuar administruar dhe autorizuar, konform kërkesave ligjore të ligjit nr.80/2015, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 06. 02.2. 2012 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar,
- Në të gjitha institucionet e IAL është konstatuar mos realizim i të ardhurave nga tarifa e shkollimit, ku janë reflektuar dhe efektet që kanë pasur rastet përjashtimore me VKM.

#### **Prokurimeve Publike,**

- Në disa institucione është konstatuar mangësi të ndryshme si (mangësi në hartimin e preventivave, proces-verbalit, të konstatimit të defekteve, situacioneve, proces-verbaleve të marrjes në dorëzim etj).

#### **Zbatimin e akteve ligjore e nënligjore përkatësisht:**

Mbi zbatimin e ligjit nr. 69/2012 , datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit nr. 175, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar si dhe të Udhëzimit nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar “Për emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në Arsimin Parauniversitar”;

- Ne disa shkolla drejtuesit e shkollave nuk marrin normën e plotë mësimore ose realizojnë orë mësimore jashtë profilit të tyre.
- Në disa raste nëndrejtorët janë nën normë ose zhvillojnë orë mësimore jashtë profilit.
- Disa shkollat aktivizojnë mësues jashtë profilit për shkak të nevojave të plotësimit të normës së individëve të veçantë apo të zgjidhjes së situatave të ndryshme, nganjëherë dhe konfliktuale, që krijohen gjatë ndarjes së ngarkesës mësimore.
- Disa DAR/ZA-të punësojnë mësues pa arsimin dhe kualifikimin e duhur.
- Për vitin 2017-2018, gjatë monitorimit të disa DAR-eve janë konstatuar punësime të punonjësve pa titullin mësues, konform ligjit për profesionet e rregulluara si dhe ligjit nr.69/2012, datë 21.6.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

## II. REKOMANDIMET

Gjatë kontrolleve të auditit të brendshëm të vitit 2018 në institucionet e varësisë së MASR, janë dhënë një sërë rekomandimesh të cilat synojnë përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në MASR.

Në përfundim të auditimeve, në zbatim të Ligjit Nr.9720 datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të ndryshuar dhe Manualit të auditimit të brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 69 datë 29.09.2010, janë dhënë rekomandime në varësi të gjetjeve sipas subjekteve të audituara.

Janë dhënë rekomandime për masa disiplinore masa të cilat janë pranuar nga menaxhimi i institucioneve të audituara, si dhe nga menaxhimi i Lartë në Ministri.,

Nisur nga rekomandimet e grupit të inspektimit të bazuara në gjetjet e këtij procesi për vitin 2017 janë marrë masat disiplinore: “zgjidhje e menjëhershme e kontratës të implikuar në shkelje të hapur të ligjit”, “vërejtje me paralajmërim” “vërejtje”.

### ***Ndër rekomandimet kryesore të dhëna nga auditët janë:***

- Për shkeljet me dëm ekonomik, është kërkuar ndjekja e rrugës ligjore për arkëtimin e tyre.
- Të përditësohet rregullorja e brendshme sa herë ndryshon struktura dhe përshkrimet e punës së punonjësve.
- Të ndahet funksioni i konstatimit të detyrimeve/ të ardhurave nga tarifat e shkollimit me arkëtimin e tyre në institucionet e sistemit të arsimit, konform standardeve të kontabilitetit.
- Të bëhet kontrolli i listëprezencave, listëpagesave, librit të pagesave dhe rregjistrave/ proces-verbaleve mësimorë apo të provimeve, para se të bëhet trajtimi financiar me mbikohë pune.
- Të bëhet caktimi i detyrave konkrete lidhur me kundërveprimin ndaj rrisqeve konkrete për punonjës konkretë duke u udhëhequr nga parimi i evitimit të shkrirjes së përgjegjësive nepërmjet ngarkimit të një detyre një grupi punonjësish mundësisht sa më të madh në numër.
- Të ndiqet menaxhimi i rrishtit nëpërmjet raportimit periodik tek Titullari.

### ***Rekomandime të tjera për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore;***

- Të ndryshohet/ rishikohet Vendimi Nr. 66, datë 03.02.2010 i K.M, “Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”,
- Të rishikohet Urdhri Nr.199, datë 01.12.2010 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore Vendore.”, ku të përcaktohen përshkrimet e punës për cdo DAR, sektor dhe pozicion pune.
- Të ndryshohet/ rishikohet Udhëzimin nr.3, datë 18.1.2011 të Ministrit të Arsimit “Për rregulloren e funksionimit të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”.

- Të rishikohet/ndryshohet Rregullorja e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 3874/1, datë 14.7.2011 “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.

#### **IV. MASAT E MARRA GJATE VITIT PER PERMIRËSIMIN E SISTEMIT TE KONTROLLIT TE BRENDSHEM NE NJESI DHE PLAN VEPRIMI PER TE ARDHMEN**

Gjatë vitit raportues 2018, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të kontrollit nëpërmjet kontroleve të drejtpërdrejta dhe raportimet mujore dhe tremujore nga menaxheri i çdo strukture. Gjithashtu për përshkrimin e proceseve të punës si dhe rishikimin e regjistrit të riskut për çdo drejtori në MASR dhe hartimin e strategjisë e planin e masave për minimizimin e riskut me ndikim të lartë në realizimin e objektivave.

#### **V. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM.**

**Rishikimin e Vendimin nr.175, datë 8.3.2017** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar,

3.a) paga e grupit (kolona 2 e lidhjes nr. 1), që është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas lidhjes nr. 2, “Paga për nivelin arsimor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

3.ç) **shtesa e pozicionit, (kolona 5 e lidhjes nr. 1) që është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës.**

Në këtë vendim punonjësit mësimorë në emërtesën “Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare”, janë klasifikuar në tre pozicione pune duke krijuar paqartësi në klasifikimin e tyre për punën në institucione arsimore si dhe pagën mujore sipas pozicionit.

*“Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfutur pagën e grupit në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfutojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës.*

***Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr.2 të vendimit.”.***

**Pra sa më sipër Vendimi nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar duhet rishikuar me përparësi.**

**Shfuqizimin e Udhëzimit nr. 16, datë 20.7.2011** të Ministrisë të Financave i cili vjen në kundërshtim me Vendimin nr. 511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar me Vendimit nr. 463, datë 16.6.2011. Vendimi i cituar më lart nuk i jep të drejtën Ministrisë të Financave të vendosë me udhëzime kritere shtesë që kufizojnë të drejtat që punonjësve dhe nëpunësve të administratës u janë miratuar me ligj.

Ky udhëzim vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Shfuqizimin e Vendimit nr. 395, datë 29.4.2015** “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, pasi vendimi tejkalon përgjegjësitë e ngarkuara me ligjin vjetor të buxhetit për Ministrinë e Arsimit.

**Rishikimin e lidhjes 9/1 të Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, e Këshillit të Ministrave** “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar.

**Lidhja nr.9/2 “Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore”, zëvendësohet me lidhjen nr.9/2,**



*“Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, shtesa për kushte pune”, lidhja 9/2, diskriminon në pagë dhe në vlerësim punonjësit e DAR/ZA në menaxhim me edukim në fushën e drejtësisë, në fushën e ekonomisë, si dhe inxhinierë që janë punësuar dhe realizojnë menaxhimin në këto institucione.*

*Ky vlerësim është tregues i vetëm që sot më shumë se 25% e vendeve/pozicioneve të punës në këto institucione janë vakante, po kështu rreth 25% e drejtuesve të tyre, Nëpunësve të Autorizuar janë të komanduar. Në mjaft raste kjo dukuri po vijon për periudha më shumë se një vit dhe ky proces ka sjellë cilësi më të ulët në zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

Në kuadrin e zbatueshmërisë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, për mënyrën e Analizës së Menaxhimit të Riskut si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, **është e nevojshme të ketë më tepër kualifikime**, trajnime e seminare për zbatimin e plotë të ligjit nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) apo dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financës për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve të institucioneve.

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efencës së punës, përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë institucionale për menaxhimin e fondeve publike të njësisë, duhet siguruar që në këto trajnime të certifikohen, drejtues të programeve buxhetore, nëpunës autorizues/ drejtuesve të njëjësive shpenzuese, nëpunës zbatues, si dhe një pjesëmarrje nga specialistë të tjerë, që ndjekin dhe raportojë tregues të arritjeve në arsim.